



Nr. 45 Prot.

Rrogozhinë më 06.12.2016.

Lënda: Kërkesë për Aktin e Përputhshmërisë për "Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Rrogozhinë"

Drejtuar: Znj. Adelina Greca

Drejtores e Përgjithëshme

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit



E nderuar znj. Greca,

Bashkia Rrogozhinë ka përfunduar hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për territorin e saj administrative, bazuar në Ligjin nr. 115/2014 datë 31.07.2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", si dhe në Ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Mbështetur në marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë të Zhvillimit Urban, Bashkisë Rrogozhinë dhe Bashkimi i Operatoreve Ekonomik "Atelier 4 shpk dhe Instituti i Politikave Publike dhe Private (IP3)" nr. prot 184/1 datë 13.01.2016, Bashkia e Rrogozhinës fillon procedurat për miratimin e planit në Këshillin Bashkiak dhe më pas në Këshillin Kombëtar të Territorit.

Bazuar në udhëzimet ligjore të përcaktuara në nenin 59 të VKM nr. 671 datë 29.07.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", kërkojmë të pajisemi me Aktin e Përputhshmërisë për Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Rrogozhinë.

Me anë të kësaj shkrese po ju përcjellim bashkëlidhur në format elektronik të gjitha raportet dhe hartat e Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Deklaratën Mjedisore të Ministrisë së Mjedisit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për bashkinë Rrogozhinë.

Bashkëlidhur gjeni CD dhe listën e materialin të të tre fazave.

Kryetari
Beqir Nuredini

